



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2024:174306

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 05903871

P.nr.123/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me praktikanëtn gjqësore Erona Kabashi, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.I nga ..., rruga "...” nr...., Komuna e Drenasit, për vepër penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1587/2024, datë 18.06.2024, e pas rikualifikimit juridik të bërë nga Prokurori i Shtetit, tani për vepër penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në shqyrtimin fillestar gjyqësor publik, të mbajtur me datë 05.07.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Ali Ajdini dhe të akuzuarit, me datë **05.07.2024** mori dhe publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: P.I, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur me datë ... në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe e ka vendbanimin, rruga "...” nr...., me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve të miturë, të moshës 10, 5 dhe 3 vjeçare, ka të kryer shkollën e mesme, punon kohë pas kohe në ndërtimtari, i gjendjes së dobtë ekonomike, merr ndihma sociale në shumë mujore prej 150 €, më parë i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datën 30.12.2023, rreth orës 21:10, në rrugën ... në Drenas, i akuzuari kishte poseduar substancë narkotike, ashtu që gjatë një kontrolli nga ana e Policisë, tek i akuzuari, ishte gjetur substancë narkotike, me peshë të përgjithshme prej 1.77 gram, e për të cilën pas ekzaminimit, ishte vërtetuar se është substanca narkotike e llojit marihuana -,

-me këtë ka kryer vepër penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,21,38,43,69 dhe nenit 269 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) si dhe neneve 359,360,364 dhe 449 par.2.6. dhe par.3.. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I akuzuari P.I në shumë prej **300 (treqind) €**, të cilin do të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari P.I në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të e zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siq parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarit, në vend të shqiptimit të dënimit me burg, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) Euro gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuana, me peshë të përgjithshme 1.77 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1587/2024, datë 18.06.2024, ka akuzuar të akuzuarin, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.05.07.2024, ku ka ftuar Prokurorin e Shtetit të Prokurorisë Themelore ne Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm Ali Ajdini dhe të akuzuarin, ashtu siç e parasheh neni 240 par.1. të KPP-së.

Në bazë të nenit 240 par.7. nënpar.1. pika.1. dhe 2. të KPP-së, në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka informuar të akuzuarin që ai mund të paraqes propozimet e mëposhtme, deri në datën e caktuar, e cila nuk mund të jetë më vonë se tredhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar dhe atë: 1.-çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të KPP-së dhe 2.- çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 par.1. të KPP-së. I akuzuari deklaroi se e ka kuptuar këtë të drejtë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siç e parasheh neni 241 par.1. të KPP-së. I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e të akuzuarit në mbrojtës është respektuar dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë në zbulimin e provave nga neni 239 të këtij Kodi, ashtu siç e parasheh neni 241 par.2. të KPP-së.

Para leximit të aktakuzës Prokurori i shtetit, ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës, duke deklaruar ashtu: që në vend të fjalisë “me datë 11.11.2023, rreth orës 22:00, në fshatin .., Komuna e Fushë Kosovës” duhet të jetë “me datën 30.12.2023, rreth orës 21:10, në rrugën “...” në Drenas”.

Poashtu Prokurori i shtetit, ka deklaruar se bënë rikualifikimin juridik të veprës penale, ashtu që në vend të asaj, që ka kryer veprën penale “Posedim i paautorizuar i substancave narkotike, psikotrope apo analoge nga neni 269 par.1. të KPRK-së, duhet të jetë rikualifikimi juridik “ka kryer vepër penale Posedim i paautorizuar i substancave narkotike, psikotrope apo analoge nga neni 269 par.2. të KPRK-së”.

Në bazë të nenit 241 par.3. të KPP-së, Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën e përmirësuar PP.II.nr.1587/2024, të dt.18.06.2024, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, duke përjashtuar pjesët e aktakuzës të specifikuara në par.3. të nenit 237 të këtij Kodi. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën. Në bazë të nenit 241 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit ia ka ofruar mundësinë të e pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së, ka përcaktuar se: -1.-i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; -2.-pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve; -3.-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe -4.-aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në bazë të nenit 242 par.5. të KPP-së, gjatë marrjes në konsideratë të pranimin të fajësisë, gjyqtari i mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit.

I njëjti deklaroi se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 242 par.6. të KPP-së, pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar çështjet nga par.2. të nenit 242 të KPP-së, mori aktvendim me të cilin miratoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe konstatoi deklaratimet e të akuzuarit nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Pastaj, në bazë të nenit 365 par.3. të KPP-së, gjyqtari mori aktgjykim, me të cilin të akuzuarin e shpalli fajtor për vepër penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata menjëherë sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 356 par.3. të KPP-së, mori aktvendim për caktimin e seancës për caktimin e dënimit pas shpalljes fajtor të akuzuarit P.I për vepër penale të lartëtheksuar, për të marrë informacione shtesë me rëndësi për caktimin e dënimit. Ku të pranishëm në seancën për caktimin e dënimit ishin: Prokurori i Shtetit Ali Ajdini dhe i akuzuari P.I. Ku palët e lartëcekuar, në bazë të nenit 356 par.7. të KPP-së, kanë mundur të i paraqesin gjykatës: -1.çështjet për ashpërsim të dënimit, përfshirë të dhënat nga e kaluara kriminale e të akuzuarit; -2.çështjet për zbutje të dënimit, përfshirë edhe ato relevante për zbutje të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj; -3.deklaratën ose argumentet për një dënim të përshtatshëm, qoftë me gojë ose me shkrim dhe -4.çështje tjera që gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i konsideron të rëndësishme për caktimin e një dënimi të përshtatshëm.

Në bazë të nenit 356 par.8. të KPP-së, është përcaktuar se dispozitat e zbatueshme për radhën e paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor zbatohen përshtatshmërisht gjatë seancës për caktimin e dënimit.

Në këtë seancë për caktimin e dënimit, Prokurori i Shtetit Ali Ajdini, deklaroi: mbetëm pranë aktakuzës, pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, është i mbështetur në prova materiale, prova këto nga të cilat është ngritur aktakuza. Andaj vlerësoi se ky pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni edhe mbështetur mu në këto prova dhe në pajtim me vullnetin e të akuzuarit. I propozoi gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë të e merr si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari P.I, deklaroi: e kam pranuar fajësinë, gjykatës i premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohem për veprën e kryer penale, kërkoi falje, e pranoi se kam gabuar, shprehi keqardhje, deklaroi se para pesë vite, deri sa kam punuar ne Slloveni, kam pasur probleme shëndetësore me sistemin nervor, kam pasur ankth, për shkak se jam operuar nga hernia diskale-boshti kurrizor dhe kam pasur dhimbje të mëdha, dhe për këtë arsye kam përdorë marihuana, në mënyrë që, të përballoj dhimbjet e mëdha, dhe prej rastit që më është gjetur substancë narkotike, për çka jam sot në gjykatë, nuk jam duke e përdorë, deklaroi se ky është rasti i parë që jam në gjykatë, është rasti i parë që kam kryer vepër penale, kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke i vlerësuar me ndërgjegje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 360 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmban aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të akuzuarit permbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPK-së, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

I akuzuari e ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, të parashikuar nga neni 269 lidhur me par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), kjo vepër penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë vepër penale i akuzuari është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1. të KPRK-së, thuhet se “kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është menderisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”. Në rastin konkret i akuzuari këtë vepër penale e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, nuk ka të dhëna se ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, gjykatës i premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohet për veprën e kryer penale, kërkoi falje, e pranoi se ka gabuar, shpreh keqardhje, i martuar, mbajtës i familjës, kryefamiljarë, baba i tre fëmijëve të miturë, të moshë 10, 5 dhe 3 vjeçare, i gjendjes së dobët ekonomike dhe merr ndihma sociale në shumë mujore prej 150 €, ndërsa rrethana rënduese gjeti se kemi shkallë të lartë të dashjes nga i akuzuari gjatë kryerjes së kësaj vepre penale. Andaj edhe pse për këtë vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri një (1) vit, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) € (nëse i akuzuari P.I në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të e zëvendësojë dënimin

me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë), me bindjen se dënimi me gjobë është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që i akuzuari, të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, gjykata e bazoi nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së. duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet 20 €.

Vendimin që të akuzuarit, të i konfiskohet sasia e substancës narkotike e llojit marihuana, me peshë të përgjithshme 1.77 gram, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 269 par.3. të KPRK-së, ku është përcaktuar se “substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen”.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.123/2024, datë:05.07.2024

Praktikantja gjyqësore
Erona Kabashi

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).